



Departamenti për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim

Prishtinë, 28 janar 2008

Zëvendës Shefi i UNMIK-ut, Larry Rossin, u prit në takim pune nga lideri i AKR-së, z. Behgjet Pacolli

Zëvendës Shefi i UNMIK-ut, Larry Rossin, u takua të premten, në zyre të AKR-së, me Kryetarin e kësaj partie, z. Behgjet Pacollin.

Z. Pacolli duke falënderuar përzemërsisht, zv. Shefin e UNMIK-ut për vizitën, i shprehi atij gatishmërinë e AKR-së për të bashkëpunuar ngushtë me institucionet ndërkombëtare. **“Është me të vërtetë kënaqësi që iu kemi sot këtu, dhe iu garantoj se jeni gjithmonë i mirëseardhur në ambientet e AKR-së”** – tha z. Pacolli, duke iu drejtuar zv. Shefit të UNMIK-ut, Larry Rossin.

Z. Rossin, shprehi bindjen se UNMIK-u ka bërë një punë të lavdërueshme në Kosovë, duke i kontribuar fuqishëm periudhës së tranzicionit dhe duke ndihmuar ndërtimin e institucioneve vendore. **“Edhe pse UNMIK-u, po e përfundon misionin e tij në Kosovë, unë jam i bindur se po lëmë pas një administratë funksionale dhe mbi të gjitha kosovarët tashmë janë të gatshëm të menaxhojnë vet institucionet e tyre”** – shtoi zv. Shefi i UNMIK-ut, Larry Rossin.

Duke folur për Aleancën Kosova e Re dhe për përudhën e funksionimit të saj, prej themelimit e deri tash, z. Pacolli potencoi faktin se AKR në vazhdimësi po luan një rol konstruktiv. **“Objektivat e AKR-së janë të qarta, ne kemi krijuar një institucion të fuqishëm politik, i cili është i gatshëm të bartë një sërë reformash në vend. AKR ka një program të qartë ekonomik shumë të nevojshme për zhvillimin e Kosovës. Prandaj jemi të bindur se pas Pavarësisë, Kosovës, do t’i nevojitet zhvillim ekonomik dhe gatishmëri për bashkëpunim me të gjitha vendet. Prandaj, ne besojmë se AKR mund të bartë këto reforma të fuqishme, që do t’i nevojiten Kosovë, pas shpalljes së statusit final të saj”** - tha lideri i AKR-së, Behgjet Pacolli. Ai shtoi se partia të cilën e udhëheq, ka 13 ulëse në Parlamentin e Kosovës dhe duke qenë në opozitë, AKR do të luaj një rol konstruktiv dhe do të bartë me seriozitet përgjegjësin dhe besimin e popullit të Kosovës.

Z. Pacolli i bëri me dije, zv. Shefit të UNMIK-ut edhe për aktivitetin e tij para formimit të AKR-së. **“Unë kam pas angazhuar një lobim të fuqishëm në SHBA, që përbëhet nga personalitete të rëndësishme në arenën ndërkombëtare, të cilët krijuan marrëdhënie shumë të mirë me Departamentin e Shtetit atje. Ata ishin të përkushtuar të sensibilizonin bashkësinë ndërkombëtare për Pavarësinë e Kosovës”** –tha z. Pacolli. Ai shtoi se Kosova dhe institucionet e saj, janë para një sfide të madhe, që është shpallja e Pavarësisë së vendit tonë. Mbi të gjitha ai nënvizoi faktin se kjo shpallje detyrimisht duhet të bëhet në koordinim me bashkësinë ndërkombëtare dhe kjo duhet të ndodh shumë shpejt.

Zv. Shefi i UNMIK-ut, Larry Rossin tha se Kosovës i nevojitet një qeveri e fortë dhe shumë funksionale, por nga ana tjetër i duhet edhe një opozitë shumë konstruktive. **“Jam me të vërtetë i impresionuar me veprimet e AKR-së në legjislativin e Kosovës”**- tha z. Rossin, ai shtoi se kjo parti po luan një rol të fuqishëm dhe mbështetja që i dha AKR-ja institucioneve të Kosovës në këtë fazë është shumë e qëlluar dhe e domosdoshme për krijimin e institucioneve funksionale në vend.

Në takim ishin të pranishëm edhe nënkryetari, njëkohësisht dhe Shef i Grupit Parlamentar të AKR-së, z. Ibrahim Makolli, Shefi i Protokollit të kësaj partie, z. Shpend Kallaba dhe Zëdhënësi, Arbër Geci.